



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.24/2018
Prishtinë, më 12.4.2018, në orën 09:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj, Mimoza Kusari – Lila, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Sala Berisha- Shala, kryetare, Hykmete Bajrami dhe Gani Dreshaj, anëtarë.

Të ftuar: Arsim Janova, u.d. i kryesuesit të Bordit të ZRRE-së.

Pjesëmarrës të tjerë: Besim Sejfiqaj, Selman Hoti, Izet Rushiti, Petrit Pepaj, Fidan Isufi, Ymer Fejzullahu – ZRRE, Dardan Abazi - INDEP; Adelina Hasani - KDI; Arbenita Marmullaku - RTK-Radio, Donila Osmani - Ekonomia Online, Nerënxa Jakupi – Kosova Press, Dorentina Kastrati – BIRN, Liridon Gashi –SEFF, Dora Musa – INDEP dhe Etleva Malushaj – GDP.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 29 dhe 30.3.2018;
3. Prezantim nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë - ZRRE, të Parametrave Rregullativ, me anën e të cilave caktohen të hyrat dhe tarifat e operatorëve dhe tarifat përfundimtare të konsumatorëve;
4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE, për vitin 2017;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Mimoza Kusari – Lila, theksoi se grupi punues e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit, dhe propozoi që në rend të ditës të futet edhe shqyrtimi i projektligjit me propozim amendamentet e grupit punues.

Rendi i ditës u miratua duke përfshirë edhe propozimin e deputetes znj. Kusari-Lila.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 29 dhe 30.3.2018

Procesverbalet nga mbledhjet e datës 29 dhe 30.3.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Prezantim nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë - ZRRE, të Parametrave Rregullativ, me anën e të cilave caktohen të hyrat dhe tarifat e operatorëve dhe tarifat përfundimtare të konsumatorëve;

Kryesuesi, bëri të ditur se në mbledhje të komisionit përfaqësuesit e ZRRE-së do të paraqesin procesin tarifor që është duke u zhvilluar nga ZRRE-ja .

Ymer Fejzullahu, ZRRE, paraqiti procesin tarifor, duke u fokusuar në Shqyrtimin Periodik për periudhën e dytë rregullative (PRR 2) të përcaktimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), Operatorin e Tregut (OT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Si pjesë të këtij procesi, në emër të ZRRE-së prezantoi për diskutim Raportet Konsultative për përcaktimin e Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC), për Vlerësimin e Jetëgjatësisë së Aseteve dhe Raportin për Reduktimin e Humbjeve të energjisë elektrike.

Mimoza Kusari–Lila, pyeti se në kuadër të efikasitetit ndër vite, cili është ndryshimi në faktorin e efikasitetit në procesin e privatizimit? A është parapare në cakun e humbjeve edhe kjo energji, e cila tash po furnizohet nga KOSTT-i? Termi humbje politike a është term i cili përdoret në Ligjin për energjinë, apo ju keni vendosur ta përdorni si term me të cilin po ballafaqohemi tash prej momentit të moskontrollit të shpërndarjes së energjisë elektrike në veri? Ku është kufiri teknik, në cilën pikë është në raport me veriun e Kosovës, më intereson ta dijë gjeografikisht? Humbjet teknike, komerciale dhe humbjet totale, përcaktimi i rajoneve në nivel të humbjeve, a mund të na tregoni specifikat e humbjeve në rajone?

Arsim Janova, ZRRE, sqaroi se sa i përket termit të humbjeve politike, nuk është term i cili përdoret në ligj, është përdorur në zhargonin tonë dhe këto humbje më shumë mund të hyjnë tek humbjet komerciale edhe pse nuk është 100% adekuat të përdoret as të humbjet komerciale sepse ka qenë një humbje e veçantë.

Mimoza kusari – Lila, shtoi se nuk është në rregull të përdoret termi humbje politike, sepse ne e trajtojmë me mandat kushtetues të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, në mënyrë të barabartë.

Ymer Fejzullahu, ZRRE, theksoi se sa i përket performancës së efikasitetit, në kohën kur është privatizuar KEDS-i, në tri vitet e para nuk ka pasur performancë sa i përket efikasitetit, sepse ka qenë obligim me kontratë të mbajë numrin e njëjtë të punëtoreve, ndërsa në dy vitet e fundit performanca e efikasitetit, pas uljes së numrit të punëtoreve ka ngritje për 5%. Sa i përket humbjeve për veriun nuk mund të përcaktojmë saktë, përderisa nuk ka operator në atë pjesë. Detyrë jona është furnizimi me energji elektrike për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, në mënyrë të barabartë. Nga 2 dhjetori 2017 dhe deri me tani, përveç një muaj që ka pasur 1 milion euro subvencionim nga Qeveria, KOSTT-i ka marrë energjinë duke tërhequr nga operatorët tjerë të interkoneksionit evropian, që llogaritet të jetë energji e paautorizuar. Sa i përket kufirit teknik dhe komercial, them se kufiri komercial është në Vallaq, kurse kufiri teknik është siç e kemi me të gjitha shtetet tjera të rajonit.

Dardan Molliqaj, theksoi se kam përshtypjen se ZRRE-ja më shumë po i shërben një kompanie private, siç është KEDS, sesa qytetarëve. Politikat tuaja kanë qenë të dëmshme dhe e kanë dëmtuar ekonominë familjare në vend. Tarifat e njëtrajtshme kanë qenë në dëm të qytetarëve dhe jo në favor të tyre, dhe unë e kam të qartë se pse e kemi marrë këtë vendim, pra për t'i shërbyer kompanisë KEDS. A do të ketë ndryshim thelbësor apo si do të vazhdojë kjo punë. Ajo që vërehet është se në vitet e para të privatizimit ka pasur rënie të humbjeve, kurse në vitet e fundit kemi ngritje të humbjeve. Cili është kuptimi i rritjes së këtyre humbjeve e sidomos të humbjeve teknike? Ju si ZRRE, si rregullator nuk po i mbron interesat e qytetarëve dhe nuk po menaxhoni drejt.

Arsim Janova, ZRRE, theksoi se sa e mbrojmë interesin e qytetarëve, është vlerësim i secilit, ju e vlerësoni ndryshe si deputet, tjetri deputet e vlerëson ndryshe, qytetarët ndryshe. Mirëpo, ne si rregullator, duhet përveç qytetarëve t'i mbrojmë edhe të licencuarit dhe të gjejmë një balancë, dhe sa i përket kësaj, personalisht nuk pajtohem me vlerësimin tuaj. Sa i përket tarifave ne jemi dëshmitarë se në këtë vit gjatë dimrit kemi pasur shumë më pak ankesa sa i përket faturave.

Dardan Molliqaj, sqaroi se unë nuk bëra vlerësim subjektiv këtu, janë shifrat që e thonë këtë. Ju thoni se ka pasur më pak ankesa këtë vit, por ju nuk jeni këtu të menaxhoni me ankesa të qytetarëve, kostoja e shpenzimeve gjatë këtij viti është 30% më e madhe se sa vitet tjera, por kjo është e shpërndarë në muaj gjatë gjithë vitit.

Memli Krasniqi, theksoi se nga perspektiva personale, shoh se me tarifën e reja kam paguar më pak se sa vitet tjera. Nuk qëndron fakti që qytetarët po paguajnë 30% më shumë për energjinë e shpenzuar. Për mua është problem të sulmohet sektori privat sepse unë besoj në sektorin privat dhe kjo është bindja e ime edhe ideologjike. Në anën tjetër pajtohem se ka nevojë për investime më të mëdha, por duhet të kujdesimi të gjejmë një mesazh që të mos dëmtojmë as qytetarët dhe as investitorin.

Dardan Molliqaj, potencoi se nga 400- 500 mijë konsumator që kemi, të nisemi dhe të flasim me një analizë të një konsumatori nuk është reale, kështu që kjo që thoni ju nuk qëndron. Është një raport i përpunuar nga INDEP-i ku tregohen rritje të energjisë për kilovat për konsumatorët për rreth 30%, dhe kjo bazohet në raportin e ZRRE-së. Unë pres nga ZRRE-ja të dalin me raport të tregohet e kundërta.

Memli Krasniqi, shtoi se sa i përket raporteve të OJQ-ve të ndryshme mund të ndodh që për një çështje të njëjtë të ketë dy raporte të kundërta, dhe unë e mbështes 100% tarifën e njëtrajtshme dhe besoj se kjo është reale, madje edhe tarifata e ndryshme nga dita dhe nata nuk duhet të jenë, sepse nuk duhet të ketë kësi lloje të dallimeve.

Kryesuesi, pyeti përfaqësuesit e ZRRE-së, pse është e rëndësishme kostoja e borxhit?

Ymer Fejzullahu, ZRRE, sqaroi se është e rëndësishme për faktin se secila ndërmarrje jodomosdoshmërisht komplet financimin ose një pjesë e bënë prej kapitalit vetjak. Por, domosdoshmërisht kjo do të hyjë në kredi për investime kapitale që në bazë të propozimit të ZRRE-së do të jete 40% investime vetjake, kurse 60% nga financimi prej kredive.

Kryesuesi, pyeti se çka keni marrë për bazë për ta caktuar koston e borxhit?

Ymer Fejzullahu, është emetimi i letrave me vlerë, që sillet nga 3.1 deri ne 3.0 dhe diferenca, premiumi, që në bazë të raporteve të Bankës Qendrore të këtij viti sillet 5.8 deri ne 6.5.

Kryesuesi, pyeti se a është KEDS-i kompani profitabile?

Ymer Fejzullahu, u përgjigj se KEDS-i është kompani profitabile në bazë të parimeve që cakton ZRRE-ja, aq sa edhe çdo ndërmarrje tjetër do të duhej të ishte profitabile.

Kryesuesi, pyeti se a e dini se në sistemin bankar të Kosovës korporatat me këta parametra financiar marrin kredi me 4.7%, korporata private të cilat marrin kredi dhe nuk kanë monopol.

Ymer Fejzullahu, sqaroi se janë kredi afatshkurta dhe janë shifra nga raporti zyrtar i Bankës Qendrore.

Kryesuesi, theksoi se koston e borxhit të cilën ZRRE-ja ia ka pranuar KEDS-it, ju propozoj ta rishikoni, meqë sipas informacionit që kam nga Banka Qendrore e Kosovës dhe bankat komerciale në Kosovë dhe informacionet që kam nga bankat komerciale turke, për kreditë që jepen në nivel afatgjatë, interesi vjetor nuk kalon 4.5%. Kështu që, le të jetë si rekomandim që t'i referoheni çmimeve të parasë në treg. E dyta, ndonëse që duket numër i vogël, kjo Beta e ekuitetit, për aq sa di unë luan rol. Këta dy parametra jashtëzakonisht të rëndësishëm po i lëvizni, andaj te kostoja e borxhit 5.8 le të jetë tavani. Tek efikasiteti, ju e cekët se 3 vite nuk kemi pas efikasitet për shkak se e kanë pasur me kontratë të obliguar ta mbajnë numrin e punëtorëve. Sipas meje, ju efikasitetin po e ndërlihdni me shkarkime nga puna, nuk e di sa jeni të informuar por nga viti 2004, nuk ka rritje të pagave në KEDS. Caku i humbjeve në KEDS në vitin 2017 sipas ZRRE-së duhet të jetë 16.9, realizimi është 22.9 dhe po pritet që në 2018 të bie në 21.9 dhe në 2019, në 20.9, deri sa te arrij një cakun prej 16.9 në 2020, apo 13.2 në 2022, sa është reale kjo pritje?

Ymer Fejzullahu, sqaroi se në bazë të trendit të pesëvjeçarit të kaluar, ne kemi thënë se kjo rënie do të jetë diku rreth 1.1% në vit, dhe nëse nuk realizohet, komplet koston e kësaj energjie për mosrealizim të caktuar e bart investitori.

Kryesuesi, theksoi se si rekomandim imi është që propozimi fillestar i ZRRE-së të mos lëviz sepse edhe ashtu është propozim jashtëzakonisht gjeneroz, dhe çdo lëvizje prej kësaj na bie në situatë që përveç implikimeve që i kemi pasur në tarifa tashmë të ju japim ushqim edhe të ecë edhe më përpara. Nuk ka asnjë arsyeshmëri ekonomike për të ecur përtej këtyre numrave që i kemi propozuar si ZRRE, nëse unë si deputet mund të gjej kredi me kosto më të ultë se që propozon KEDS-i dhe kërkojmë të ketë hetim për të kuptuar se pse një operatori privat përtej asaj që jepet në treg i mundësohet të paguhet me shtrenjtë.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

I rekomandohet ZRRE-së që të mos rrisë parametrat rregullativ nga propozimi fillestar i ZRRE-së.

Në mungesë të kuorumit, kryesuesi ndërpreu mbledhjen.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, më 20.4.2018, në orën 10:00, salla N-10, ndërtesa e Kuvendit.

Pjesëmarrës nga komisioni: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetarë i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Stafi mbështetës i Komisionit: Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetarë i parë i komisionit.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për vazhdimin e mbledhjes së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE, për vitin 2017;

Kryesuesi, theksoi se do të vazhdojmë me mbledhjen me pikat e mbetura nga mbledhja e datës 12.4.2018 e cila është ndërprerë për shkak të mungesës së kuorumit. Kryesuesi ia dha fjalën z.Arsim Janova, të prezantojë Raportin vjetor të ZRRE-së për vitin 2017.

Arsim Janova, u.d. i kryesuesit të Bordit të ZRRE-së, prezantoi Raportin Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE, për vitin 2017. Ai theksoi se raporti është gjithëpërfshirës. Përmban punët, aktivitetet dhe të arriturat e ZRRE-së në kuadër të fushëveprimit të saj, raportin financiar për vitin 2017 dhe analizat dhe aktivitetet në sektorin e energjisë. ZRRE-ja gjatë vitit 2017 (deri më 15 maj 2017 sa ishte Bordi funksional) ka mbajtur 7 mbledhje, në të cilat ka nxjerrë një numër vendimesh, ka miratuar metodologji dhe procedura të sektorit të energjisë, rregulla të reja dhe ka bërë harmonizimin e disa rregullave me ligjet e reja të sektorit të energjisë. Në funksion të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, ZRRE-ja ka nxjerrë “Udhëzuesin për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë”. Përmes këtij udhëzuesi është vendosur hapja e tregut me shumicë, duke filluar me gjenerimin dhe pastaj në mënyrë graduale edhe liberalizimin e tregut me pakicë, duke e përshtatur me rrethanat e sektorit të energjisë në Kosovë. Për furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike me pakicë janë të licencuar tre furnizues, por përkundër kësaj përveç KESCO-s, dy furnizuesit tjerë ende nuk janë aktiv në treg. ZRRE-ja gjatë vitit 2017 ka bërë shqyrtimin e aplikimeve për tarifën e reja nga ana e të licencuarve në sektorin e energjisë, përfshirë veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal, si dhe të licencuarve në sektorin e energjisë termike. Nga data 1 prill 2017, ZRRE-ja ka ndryshuar strukturën tarifore me pakicë në sektorin e energjisë elektrike. Ndryshim esencial është largimi i tarifave sezonale (verë-dimër) që do të përfshijnë të gjithë konsumatorët fundorë, si dhe largimi i bllok tarifave për konsumatorët familjarë. Kanë mbetur vetëm tarifën natë – ditë. ZRRE-ja ka pranuar dhe shqyrtuar një numër të konsiderueshëm të aplikacioneve për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet Ripërtëritëse të Energjisë (BRE) të teknologjive të ndryshme dhe gjatë vitit 2017 përveç autorizimeve preliminare ka lëshuar edhe 8 (tetë) autorizime finale. ZRRE-ja gjatë vitit 2017 është ballafaquar me disa konteste gjyqësore, në lidhje me aktivitetin e saj, ndërsa me ndikim më të madh në sektorin energjetik ka qenë vendimi mbi masën e përkohshme të Gjykatës së Apelit, lidhur me trajtimin e energjisë së pa faturuar (humbje) në katër komunat e veriut të vendit. Procesi i shqyrtimit meritor i lëndës ende nuk ka filluar. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve gjatë vitit raportues, ZRRE-ja ka pranuar dhe shqyrtuar ankesa nga konsumatorët, si dhe iu ka ofruar konsultime, sqarime dhe udhëzime për veprimet e nevojshme për zgjidhjen e ankesave të tyre. Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2017 është karakterizuar me një rënie krahasuar me prodhimin në vitin 2016. Kjo rënie e prodhimit ka ndodhur për shkak të problemeve të shpronësimit në fshatrat Hade dhe Shipitullë dhe si rrjedhojë ka pas rritje të importit të energjisë elektrike për mbulimin e konsumit. Cilësia e furnizimit me energji dhe cilësia e shërbimeve nën standardet e kërkuara dhe që vërehet përmes indekseve matës (SAIDI, SAIFI, ENS, etj.) është mjaft e theksuar. ZRRE-ja është e përkushtuar që cilësia e furnizimit dhe shërbimit të arrijë standardet e duhura përmes lejimit të investimeve dhe forcimit të monitorimit të këtyre investimeve. Humbjet në rrjetin e transmetimit janë në nivel të pranueshëm, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë mjaft të larta. Sa i përket sektorit të energjisë termike gjatë vitit 2017, situata mbetet kryesisht e pandryshuar.

Duda Balje, theksoi se ju si ZRRE keni të drejtën të jepni leje për ndërtimin e hidrocentraleve, pas Ministrisë, ju jeni si hap i dytë që lëshoni leje. A keni kërkesa konkrete dhe si keni vepruar në këtë rast për ta respektuar vullnetin e qytetarëve?

Mimoza Kusari – Lila, tha se në aspektin teknik tek furnizuesit me pakicë, të licencuar sipas raportit i keni 3 (tre), përderisa vetëm KESKO është që ka furnizuar me pakicë. Çfarë ka

ndodhur ose cili është statusi i dy furnizueseve të tjerë të licencuar për furnizim me pakicë dhe në cilat zona kanë licencë për furnizim? Ka lëvizje në rritje të kapaciteteve të energjisë fotovoltike dhe për biomasën. Te e para, nga 10 në 30 megavat, kurse te biomasa nga 14 në 20 megavat. A ka kaluar në proces të konsultimit publik, në procesin e zakonshëm të vlerësimit apo si është marr vlerësimi te pjesa e rritjes së kapaciteteve, apo si është marr ky vendim? Te pjesa e furnizimit në veri, si është e mundur që ZRRE-ja i ka rekomanduar KOSTT-it për furnizim në veri dhe nuk ka marr vendim bordi për këtë, por keni nxjerrë vetëm rekomandim. Si ka qenë procesi i vendimmarrjes brenda ZRRE-së në këtë rast?

Hykmete Bajrami, potencoi se në raport shohim se janë edhe dy operatorë të tjerë të licencuar dhe në fakt ata nuk janë aktiv. Na thoni pse nuk janë aktiv? Dhe kur e dimë se KESCO-ja është në pronësi të KEDS-it dhe dyshimi është se mos po favorizohet KESCO-ja nga KEDS-i. Kush janë importuesit më të mëdhenj të energjisë elektrike? Energjinë elektrike që e prodhon KEK-u ia shet KESCO-s. A ka një limit deri në çfarë mase duhet ti shes? Pse nuk munden operatorët tjerë të blejnë energji nga KEK-u, por mundet vetëm KESCO? De fakto kemi një monopol te furnizimit me energji elektrike, kurse de jure nuk kemi monopol, sepse kemi të licencuara 6 kompani për furnizim me energji elektrike. Pse duhet KESCO-ja të trajtohet ndryshe nga të licencuarit tjerë për furnizim me energji?

Arsim Janova, sqaroi se sa i përket prodhimit të energjisë nga masat ripërtëritëse, në këtë aspekt ZRRE-ja më shume ka rol administrativ se sa që të mund të jetë ekzekutiv. Sa i përket furnizuesve me pakicë, ne deri në vitin e kaluar kemi pasur tre furnizues dhe tani prej që është kompletuar bordi, sipas kërkesës se tyre i kemi licencuar edhe tre furnizues të tjerë. Hapjen e tregut e kemi bërë hap pas hapi. Mirëpo, për arsye që nuk ka ecë procesi siç kemi menduar, ne na është dashur të prolongojmë hapat e më tutjeshëm në këtë drejtim. Ato kapacitete që janë për furnizim universal, tash për tash janë deri në kapacitetin 35 kilovolt.

Petrit Pepaj, ZRRE, sqaroi se furnizuesit e licencuar kanë trajtim të barabartë, por problemi qëndron se nuk ka ofertues për furnizim përveç KESCO-s. Ne nuk e kemi për detyrë t'i gjejmë konsumatorë furnizuesve të tjerë. E jona është t'i ofrojmë mundësi të barabarta për operim në tregun e energjisë, por ata nuk kanë mundur të ofrojnë çmim të favorshëm për konsumatorin. KEK-u ka obligim ta furnizojë me energji KEDS-in për shërbim publik, dhe këta konsumatorë të shërbimit publik e përbejnë 70% të konsumit.

Hykmete Bajrami, përsëri pyeti, pse KEK-u nuk po i shet asnjëherë energji elektrike edhe operatorëve të tjerë, cila është poenta e liberalizimit të tregut këtu? Kjo i bie se ka monopol të tregut dhe jo liberalizim. Këta operatorët e licencuar a janë komplet të painformuar për këto dukuri sepse nuk po e kuptoj cila është poenta se pse vijnë të licencohen te ju kur e din që nga dita e parë, se operimi i tyre është i pamundshëm. Nuk e kam të qartë se cila është arsyeja e licencimit.

Petrit Pepaj, ZRRE, sqaroi se KEK-u ka obligim ti jep energji elektrike KESCO-s vetëm për konsumatorë të rregulluar dhe jo për konsumatorë të parregulluar. Operatorët e licencuar kanë informata të sakta për tregun dhe kapacitetet të cilat janë të disponueshme në Kosovë. Një furnizues nuk është i detyruar domosdo të blejë vetëm nga gjenerimi, por ai e ka të drejtën të blejë kudo që e gjen ma lirë, dhe ta furnizojë cilindo klient në Kosovë. Detyrë jona është që mos

të përcaktojmë çmime të rregulluara, dhe sa më shumë të kemi konsumatorë që kërkojnë furnizues të tjerë.

Mimoza Kusari-Lila, pyeti se sa ndikon mosfunksionalizimi i linjës së interkoneksionit me Shqipërinë? Sa ndikon problemi i mosanëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E dhe çështjet politike në problemin e gjetjes së furnizuesve të drejtpërdrejt? A ndikon kjo në rritje të çmimit, gjegjësisht në rritje të problemeve për qasshmëri të shfrytëzuesve të rrymës në Kosovë.

Petrit Pepaj, ZRRE, potencoi se një ndër problemet kryesore është mosanëtarësimi i KOSTT-it në ENTSO-E. KOSTT-i nuk ka mundësi të hap tender për alokim të kapaciteteve për furnizim, dhe tani alokimin e bën KEDS-i dhe jo KOSTT-i.

Bilall Sherifi, pyeti se këto problemet me monopol a kanë ekzistuar nga qeverisja e kaluar apo janë tash nga kjo qeverisje? Këta operatorët e licencuar a janë vendorë apo ndërkombëtarë dhe sa kapital është dashtë të investohet, për të operuar në Kosovë.

Petrit Pepaj, ZRRE, sqaroi se këto probleme me monopol janë që nga fillimi. Kurse operatorët e licencuar nuk janë vendorë. Për furnizim me energji elektrike nuk janë të obliguar të kenë kapital të caktuar. Janë disa kritere të përcaktuara dhe kushdo që i përmbush këto kritere mund të operojë.

Kryesuesi, theksoi se në raport do të ishte e rëndësishme që të pasqyrohet një tabelë e detajuar në të cilën do të përfshiheshin afatet e kohëzgjatjes së këtyre licencave dhe kapaciteteve të instaluar, qoftë ato që instalohen, apo ato që priten të instalohen. Të paraqiten po ashtu të gjitha licencat aktive, ato që janë shuar, kohëzgjatja e tyre dhe koha kur skadojnë. Për operatorët që janë në fazën preliminare të marrjes së licencave, duhet cekur se kur pritet që megavatet e deklaruar të futen në sistemin energjetik. Këto le të mbesin si rekomandime për raportin e ardhshëm apo edhe si aneks i këtij raporti. Te gazi natyror në raport është shpjeguar projekti alkogap me Shqipërinë, por nuk kemi të dhënat të detajuara. Na jepni informacione më shumë mbi infrastrukturën aktuale, nivelin e investimeve që nevojiten dhe si është e organizuar industria e gazit natyror aktualisht? Sa i përket kontratës për termocentralin e ri, a e keni parë kontratën? A jeni konsultuar sa i përket ndërlidhjes së kontratës me obligimet që i ka KOSTT-i, sa i përket blerjes së parë? A jeni konsultuar për obligimet që merren me kontratë që të blihet 24 orë energji për 20 vite 420 megavatë me çmim të synuar? Ky çmim i synuar a përfshin koston e KOSTT-it për transmision dhe koston e distribuimit? Si liberalizohet tregu, me një kontratë siç është kontrata me Contour Global? Cilat janë reperkusionet sa i përket pjesëmarrjes së Kosovës në komunitetin e energjisë? A e dini sa do të jete kapaciteti gjenerues në total nëse zbatohet kontrata e Contour Global-it, përfshi të gjitha burimet që i keni me licenca preliminare? Sa megavat do t'i kemi nga burimet ripërtëritëse deri në vitin 2023? A e keni informacionin se sa është çmimi mesatar i importit në 5 ose 10 vitet e fundit? Ju si ZRRE a jeni të vetëdijshëm dhe të informuar për rritjen e kapaciteteve gjeneruese në treg? A mendoni se çmimi i importit të energjisë në 10 vitet e ardhshme do të rritet apo do të zvogëlohet? Cilat janë parashikimet e juaja?

Arsim Janova, ZRRE, sqaroi se rritja e kapaciteteve të energjisë me erë, solare dhe biomasa deri në vitin 2020, MZHE-ja ka përcaktuar caqet në bazë të kërkesave të Komunitetit të

Energjisë, ku deri diku 25% do të jenë nga burimet e ripërtëritëse. Nga udhëzimi i vitit të kaluar, tek kategoria solare është shtuar në 30 megavat solare kurse te kategoria biomasë nga 14 është bërë 20 megavat biomasë që i bie diku gjithsej 440 megavatë kapacitete të përgjithshme nga burimet e ripërtrishme. Sa i përket rekomandimit për KOSTT-in, nuk kemi marr vendim Bordi i ZRRE-së, por vendimin e Gjykatës e kemi përcjelle vetëm si njoftim dhe nuk ka qenë në autoritetin tonë të vendosim se si të veprojnë. Ai potencoi se caqet deri në vitin 2020 janë 340 megavatë, kurse deri në vitin 2023 do të arrihen 440 megavatë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë. Kapacitete të instaluar deri ne vitin 2023, do të jene rreth 140 megavatë, pra 40% e caqeve të përgjithshme. Sa i përket kontratës me Countour Global, ne natyrisht që e kemi parë dhe kemi qenë pjesë e diskutimeve dhe më pas edhe e finalizimit të kësaj kontrate. Sa i përket kapaciteteve të instaluar, nëse funksionalizohet edhe “Kosova e Re”, deri ne vitin 2023 mendohet të arrijë kapaciteti deri në 1400 megavatë. Liberalizimi i tregut është në fazën fillestare dhe ne kemi marrë hapin e parë në këtë drejtim, dhe natyrisht që kemi probleme sepse jemi në fazën fillestare dhe në këtë drejtim kemi kërkuar ndihmë edhe nga Komunitetit i Energjisë.

Petrit Pepaj, ZRRE, sqaroi se çmimin e importit e kemi në raport ne faqen 96, tabela 5.27, e ku çmimi mesatar sillet aty diku rreth 60 euro megavate për orë, ndërsa në vitet e ardhshme në bazë të parashikimeve të ZRRE do të këtë një rënie të çmimit të importit.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë rekomandim:

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), për vitin 2017, me rekomandimet si në vijim:

- Në raportet vijuese ZRRE-së të përfshihen detaje për afatet e kohëzgjatjes së licencave dhe kapacitetet e instaluar, qoftë ato që instalohen apo ato që priten të instalohen. Po ashtu, në raport të paraqiten të gjitha licencat aktive dhe ato që janë shuar.*
- Të shtohet kontrolli i licencave preliminare dhe përfundimtare, duke vendosur afate të qarta, se kur pritet që kapacitetet e deklaruara të futen në sistemin energjetik.*

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit;

Kryesuesi, theksoi se Grupi i punës e ka amendamentuar këtë projektligj dhe ka paraqitur raport me amendamente, dhe ia kaloi fjalën deputetes, znj. Mimoza Kusari- Lila, si kryesuese e grupit punues.

Mimoza Kusari- Lila, tha se grupi punues e ka përfunduar amendamentimin e Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit dhe se ky projektligj ka kaluar në të gjitha fazat e konsultimit publik

përfshirë edhe komentet shtesë që kanë ardhur pas përfundimit të dëgjimit publik. Kemi pasur një çështje teknike për përmirësim të referencave, e cila është rregulluar me procedurë të amendamentimit. Gjithsejte grupi punues ka nxjerrë 38 amendamente. Ky projektligj i plotëson kushtet që të shkojë për komisionet e përhershme dhe ju ftoj që ta votoni raportin me amendamente.

Kryesuesi, propozoi që, nëse nuk ka ndonjë vërejtje rreth amendamenteve, t'i votojmë në bllok.

Propozimi i kryesuesit u përkrah nga komisioni.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit.*
- 2. Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës.*

Raporti me amendamente i bashkëngjitet këtij procesverbali.

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Zëvendëskryetarë i parë i Komisionit

Dardan Sejdiu,



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Komisioni për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Komisioni për Integritet Evropian;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit;

Datë: 20.4.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 20.04.2018, e shqyrtoi dhe amendamenti Projektligjin nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 1, nënparagrafi 1.2, fshihet fjala “afatgjatë”.

Amendamenti 2

Neni 2, paragrafi 1, fshihet fjala “rezident”.

Amendamenti 3

Neni 6, paragrafi 1, referencës “në Nenin 8” i shtohet fjalia “të këtij Ligji”, dhe kjo vlen për tërë tekstin e projektligjit kur kemi referenca në këtë projektligj.

Amendamenti 4

Neni 15, në tërë nendin pas fjalës “alkoolike” shtohet edhe “dhe duhanit”.

Amendamenti 5

Neni 16, pas paragrafit 7, të shtohet edhe një paragraf i ri si vijon:

“8. Përveç kërkesave të përcaktuara në këtë nen dhe dispozitat e tjera të këtij Ligji, shitësi detyrohet të tregoj origjinën e produktit edhe përmes vendosjes së një etikete që tregon flamurin e shtetit të origjinës së produktit. Flamuri duhet të vendoset afër çmimit të shitjes apo çmimit për njësi”.

Amendamenti 6

Neni 31, referenca “nenit 54” zëvendësohet me bëhet “neneve 26 deri 30”.

Amendamenti 7

Neni 39

Paragrafi 1.11, referenca “nenin 41, paragrafin 8” zëvendësohet me “nenin 41, paragrafin 9”, dhe referenca “nenin 47, paragrafin 3” zëvendësohet me “nenin 47, paragrafin 5”.

Paragrafi 1.15, referenca “nenin 3, nënparagrafin 1.27” zëvendësohet me “nenin 3, nënparagrafin 1.20”.

Amendamenti 8

Neni 40, paragrafi 3, referenca “nenin 20” zëvendësohet me “nenin 42, paragrafin 2”.

Amendamenti 9

Neni 41

Paragrafi 5, referenca “në nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.9 dhe 1.16 të nenit 39” zëvendësohet me “në nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.5, 1.9 dhe 1.16 të nenit 39”.

Paragrafi 6, referenca “paragrafin 4 të këtij neni” zëvendësohet me “paragrafin 5 të këtij neni”.

Paragrafi 9, referenca “nenin 40” zëvendësohet me “nenin 42, paragrafin 2”.

Amendamenti 10

Neni 43, paragrafët 1 dhe 2, referenca “nenin 40” zëvendësohet me “nenin 42”.

Amendamenti 11

Neni 47, paragrafi 1, referenca “nenin 42” zëvendësohet me “nenin 44”.

Amendamenti 12

Neni 61, paragrafët 2 dhe 3, referenca “nenet 64 dhe 65” zëvendësohet me “62 dhe 63”.

Amendamenti 13

Neni 64, paragrafi 1, referenca “nenin 94” zëvendësohet me “nenin 63”.

Amendamenti 14

Neni 65, paragrafi 4, referenca “paragrafët 1 dhe 3 të nenit 62” zëvendësohet me “nënparagrafin 1.1.4 të paragrafit 1 të nenit 62 të këtij ligji”.

Amendamenti 15

Neni 66, paragrafi 3, referencës “paragrafit 1” i shtohet teksti “të këtij neni”, si dhe referenca “paragrafin 1 dhe nënparagrafin 1.1 të paragrafit 3 të nenit 62” zëvendësohet me “nënparagrafin 1.2.2 të paragrafit 1 të nenit 62”.

Amendamenti 16

Neni 73 titullohet si vijon: “Padrejtësia e një kushti kontraktuar”.

Amendamenti 17

Neni 74 titullohet si vijon: “Gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme të kushteve të kontrantës”.

Amendamenti 18

Neni 75 titullohet si vijon: “Mbrotjtja ligjore nga kushtët e padrejta në kontratë”.

Amendamenti 19

Neni 77, paragrafi 4, referenca “në nënparagrafin 2.4 të këtij neni” zëvendësohet me “nënparagrafin 2.4 të paragrafit 2 të këtij neni”.

Amendamenti 20

Neni 78, paragrafi 2, referenca “paragrafët 5 dhe 6” zëvendësohen me “paragrafët 6 dhe 7”.

Amendamenti 21

Neni 81, paragrafi 5, referenca “nenet 77, 78 ose 79 të këtij ligji” zëvendësohet me “paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni”.

Amendamenti 22

Neni 84

Paragrafi 2, referenca “nenet 93, 94, 96, dhe nenet 98 deri 102” zëvendësohet me “nenet 93, 96, 98 dhe nenet 100 deri 102 të këtij ligji”.

Paragrafi 3, referenca “nenet 97 dhe 99” zëvendësohen me “99 dhe 101 të këtij ligji”.

Paragrafi 5, referenca “nenet 97 deri 102” zëvendësohen me “99 deri 102 të këtij ligji”.

Amendamenti 23

Neni 85, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, referenca “në nenin 84 paragrafin 1.3” zëvendësohet me “në nenin 84 paragrafin 2”.

Amendamenti 24

Neni 86

Paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, referenca “nenin 107” zëvendësohet me “nenin 97”.

Paragrafi 1, nënparagrafi 1.18, referenca “me paragrafin 2 të nenit 90” zëvendësohet me “me nenin 90 të këtij ligji”.

Paragrafi 3, referenca “dhe 1.8” zëvendësohet me “dhe 1.9”.

Amendamenti 25

Neni 87

Paragrafi 1, referenca “nenin 84 paragrafët 2 dhe 5” zëvendësohet me “nenin 84 paragrafët 2, 4 dhe 5”.

Paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, referenca “nenin 84 paragrafin 3” zëvendësohet me “nenin 84 paragrafin 2”.

Paragrafi 1, nënparagrafi 1.10, referenca “nenin 90 paragrafin 2” zëvendësohet me “nenin 90”.

Paragrafi 1, nënparagrafi 1.11, referenca “nenin 84 paragrafin 3” zëvendësohet me “nenin 84 paragrafin 2”.

Amendamenti 26

Neni 91, paragrafi 3, referenca “nënparagrafi 2.8 i paragrafit 2 të këtij neni” zëvendësohet me “nënparagrafët 2.8 dhe 2.10 të paragrafit 2 të këtij neni”.

Amendamenti 27

Neni 95, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1, referenca “sipas nënparagrafit 2.16” zëvendësohet me “sipas nënparagrafit 2.17”.

Amendamenti 28

Neni 109, paragrafi 4, referenca “sipas paragrafit 2 të nenit të këtij ligji” zëvendësohet me “sipas paragrafit 2 të nenit 104 të këtij ligji”.

Amendamenti 29

Neni 119, nënparagrafi 1.4, ndryshohet si vijon:
“1.4. individi në emër të interesit kolektiv.”.

Amendamenti 30

Neni 137, në nënparagrafin 1.1. lidhëza “dhe” zëvendësohet më “deri”.

Amendamenti 31

Neni 137, paragrafi 1, në të gjithë nënparagrafet, fshihet përemri “Ai” në çdo fillim të nënparafeve.

Amendamenti 32

Neni 137, në nënparagrafin 1.1. pas fjalës “alkoolike” shtohet fjalia “dhe duhan,”.

Amendamenti 33

Neni 137, nënparagrafi 1.3., referenca plotësohet si vijon: “sipas Nenit 16 paragrafi 1 dhe 8”.

Amendamenti 34

Neni 138, paragrafi 1, ndryshohet shuma e denimit nga “1.500 euro” në “5.000.00 euro deri ”.

Amendamenti 55

Neni 138, paragrafi 1, në të gjithë nënparagrafet, fshihet përemri “Ai” në çdo fillim të nënparafeve.

Amendamenti 36

Neni 139, në nënparagrafin 1.1. lidhëza “dhe” zëvendësohet më “deri”.

Amendamenti 37

Neni 139, paragrafi 1, në të gjithë nënparagrafet, fshihet përemri “Ai” në çdo fillim të nënparagrafëve.

Amendamenti 38

Neni 140, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf i ri si vijon:

“3. Neni 16.8, hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.”

Zëvendëskryetarë i parë i Komisionit

Dardan Sejdiu,